



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr 18749 prot.

Shkodër, me 19.09.2024

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

### KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin **PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDIT BRËNDA TË NJËJTIT PROGRAM PËR VITIN 2024**

*Duke ju uruar punë të mbarë.*

Me respekt,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr \_\_\_\_\_ prot.

Shkodër, me \_\_\_\_\_.2024

PROJEKT-VENDIMI

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.2024

PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDIT BRËNDA TË NJËJTIT PROGRAM  
PËR VITIN 2024

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot me datë \_\_\_/\_\_\_/2024, në mbështetje të nenit 54 gërma "dh" të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 54 pika "c" të ligjit nr. 10465 datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr. 475 datë 30.07.2021 "Për bashkëpunimin e njëjësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar; ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; ligjit nr. 97/2023 "Për Buxhetin e vitit 2024"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 24.01.2024"; VKB nr 55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër" të ndryshuar; Vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr. 75 datë 23.02.2024 "Për miratimin e rishpërndarjes së fondit, brenda të njëjtit program për vitin 2024", sipas relacionit të përgatitur nga administrata e bashkisë dhe me propozim të Kryetarit të bashkisë Shkodër,

V E N D O S I

1. Miratimin e rishpërndarjes së fondit nga programi 4220 "Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve" si më poshtë:

Pakësime viti 2024

						Lekë
Nr	Nr Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Art.602 Mallra dhe Shërbime	Art.231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	Institucioni Likuidues
I	4220 Kap. I	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	P04220.Q1.O1.A1 Trajtimi i qenve të rruges  A2 Paisje dhe medikamente për klinikën në strehëz	510.000		Bashkia Shkodër
		<b>Totali</b>		510.000		

Nr	Nr Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Art.602 Mallra dhe Sherbime	Art.231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	Institucioni Likuidues
1	4220 Kap I	Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve	P04220.Q1.O1.A1 Trajtimi i qenve te rruges  A6 Blerje pushkë CO2 për klinikën në strehëz		510.000	Bashkia Shkodër
		<b>Totali</b>			510.000	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Zv. Kryetar

*Drind Beqeri*



Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit

të Qëndrueshëm Ekonomik

*Belqin Nema*

Drejtorja e Përgjithshme  
e Menaxhimit Financiar

*Senke Hoxha*

Drejtorja e e Financës

*Edlira Ujuzdrin*

Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural  
dhe Trajtimimit AMTP

*Sokol Maja*

Drejtoria e Analizës  
Programimit Buxhetor

Nikoleta Lubani

Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe  
Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve  
Mbështetëse

Joni Xesha

Drejtoria Juridike

B. Xesha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM**  
**EKONOMIK**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_ 2024

RELACION

**PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDIT BRËNDA TË NJËJTIT**  
**PROGRAM PËR VITIN 2024**

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Shkodër konform përmbushjes së detyrimeve , sipas përcaktimeve ligjore të parashikura në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, VKB nr.55 datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar, Vendimit të kryetarit të bashkisë nr. 75 datë 23.02.2024 “ Për miratimin e rishpërndarjes së fondit, brënda të njëjtit program për vitin 2024.

- Në programin, “Sherbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve” në aktivitetin P04220.Q1.O1.A1 “Trajtimi i qenve të rrugës” fond i parashikuar për vitin 2024 me kod 602 “shpenzime operative”, ka nje teprice prej 510,000 leke të cilat kanë qënë të parashikuara për tu përdorur për paisjen e klinikës veterinare pranë strehzës së qenve. Duke qënë se proceduara e trajtimit të qenve të rrugës parashikon kapjen e tyre dhe më pas trajtimin veterinar dhe strehimin në strehzë lind domosdoshmëria e paisjes së klinikës veterinare me nje pushkë neutralizuese në mënyrë që të lehtësohet procedura e kapjes së këtyre kafshëve. Kjo paisje përdoret, dhe është e miratuar të përdoret, për raste të tilla sidomos kur kapja e kafsheve ne kushte rruge është e pamundur me mjete të tjera .

Për këtë arsye referuar bazës ligjore: ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar , ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar : ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar : ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar: ligjit nr. 97/2023 “ Për Buxhetin e vitit 2024” ; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “ Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 24.01.2024”, VKB nr 55 datë 29.12.2023 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar : shkresës së Drejtorisë së Financës Nr. 1620/b Prot. datë 22.08.2024 “ Informacion për procedurat të cilat nuk janë realizuar të plota nga operatorët ekonomik”. kërkojmë nga ana juaj mundësinë e miratimit të rishpërndarjes së fondit brënda të njëjtit program si më poshtë detajuar:

Pakësime viti 2024

Lekë

Nr	Nr Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Art.602 Mallra dhe Sherbime	Art.231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	Institucioni Likuidues
1	4220 Kap. 1	Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve	P04220.Q1.O1.A1 Trajtimi i qenve te rruges  <i>A2 Paisje dhe medikamente për klinikën në strehëz</i>	510,000		Bashkia Shkodër
		<b>Totali</b>		510,000		

Shtesa viti 2024

Lekë

Nr	Nr Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Art.602 Mallra dhe Sherbime	Art.231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	Institucioni Likuidues
1	4220 Kap 1	Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve	P04220.Q1.O1.A1 Trajtimi i qenve te rruges  <i>A6 Blerje pushkë CO2 për klinikën në strehëz</i>		510,000	Bashkia Shkodër
		<b>Totali</b>			510,000	

**Duke ju falenderuar!**

Drejtoria e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

**Bekim MEMA**

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit AMTP

**Sokol MALAJ**

